




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2019





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit 2019



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Dhjetor, 2019

© : Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet <http://ask.rks-gov.net/>

Parathënie

Zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit e kanë transformuar shoqërinë moderne në një "shoqëri informacioni". Karakteristika e tij kryesore është se teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit luajnë rolin më të rëndësishëm në prodhim dhe ekonomi, si dhe në të gjitha sferat e tjera të jetës së individëve dhe shoqërisë në tërësi.

Në vitin 2017, njëسيا e Standardit Jetësor pranë ASK-së e ka implementuar për here të parë anketën TIK sipas metodologjisë së Eurostatit. Ky është publikimi i tretë me radhë për rezultatet e përdorimit të teknologjisë informative dhe të komunikimit nga ekonomitë familjare dhe individët i cili përmbanë të dhënat për vitin 2019 si dhe krahasueshmeri me vitet paraprake. Anketa është zhvilluar në tërë territorin e Republikës së Kosovës në ekonomitë familjare dhe për individ të kategorisë 16-74 vjeç. Periudha e referencës ishte tre muaj përpara intervistës. Të dhënat janë grumbulluar përmes metodes CAPI (Tabletit) duke zhvilluar intervistën e drejtpërdrejt në ekonomi familjare.

Anketa në ekonomitë familjare u krye në një mostër dyfazësh, faza e parë në zgjedhjen e mostrës në rajon dhe faza e dytë mostra në qarqe regjistruese. Ekonomitë familjare janë zgjedhur me metodën e rastit. Madhësia e mostrës është 3750 familje dhe 3750 individë

Anketa në ekonomitë familjare u krye në një mostër dyfazësh, faza e parë në zgjedhjen e mostrës në rajon dhe faza e dytë mostra në qarqe regjistruese. Ekonomitë familjare janë zgjedhur me metodën e rastit. Madhësia e mostrës është 3750 familje dhe 3750 individë.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato mund të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-gov.net.

Avni Kastrati – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
Naime Rexhepi – Shefe e divizionit të Statistikave Sociale.

Publikimin përgatitën:

1. Hydai Morina – Zyrtar i statistikave të Standardit Jetësor dhe
2. Marigona Ukaj- Zyrtare e statistikave të Standardit Jetësor
3. Ahmet Cakolli – Zyrtar për dizajnim
4. Kumrije Beqiri - Zyrtare në sektorin e Shpërndarjes

Lista e shkurtesave

- TIK - Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
- ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
- DSS - Departamenti i Statistikave Sociale
- CAPI - Asistencë kompjuterike për grumbullimin e të dhënave

Përmbajtja


Faqe

1 Qasje në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Ekonomitë Familjare.....	5
1.1 Qasje në internet në shtëpi apo banesa	5
1.2 Përdorimi i internetit sipas grup moshave	6
1.3 Përdoruesit e internetit sipas gjinisë	7
1.4 Lloji i qasjes në internet.....	8
2 Përdorimi i internetit nga individët 16-74 vjet në vitin 2019	9
2.1.Përdorimi i internetit herën e fundit	9
2.2.Përdorimi i internetit gjatë 3 muajve të fundit.....	10
2.3.Përdorimi i internetit disa herë gjatë ditës.....	11
2.4.Përdorimi i pajisjeve elektronike për tu qasur në internet larg nga shtëpia ose puna gjatë 3 muajve të fundit	12
2.5. Përdorimi i hapsirës në internet për qëllime private te shërbimeve online për ruajtjen e dokumenteve gjatë 3 muajve të fundit.....	13
3 Përdorimi i E-Qeverisë	14
3.1. Përdorimi i internetit për qëllime private për shërbime publike, Agjencitë Qeveritare ose administrata, gjatë 12 muajve të fundit.....	14
4 Përdorimi i E-Tregtisë.....	15
4.1. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve në internet herën e fundit	15
4.2. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit gjatë 12 muajve të fundit	16
4.3. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit gjatë 3 muajve të fundit në vitet, 2018-2019	17
4.4. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve për përdorim privat internetit gjatë 3 muajve të fundit në vitet 2018-2019	18
5 Siguria ne internet	19
5.1. Kopje ose rezervë të File-ve tuaj (dokumentave, fotografive etj.) në çdo pajisje të jashtme ose në hapësirën në internetit (shërbime cloud) për qëllime private	19
6 Konkluzione.....	20

1 Qasje në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Ekonomitë Familjare

1.1 Qasje në internet në shtëpi apo banesa


Graf 1. Ekonomitë familjare në Kosovë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa në vitet 2017-2019 shprehur në përqindje, (%)



Siç vërehet në Graf.1, në vitin 2017 përqindja e ekonomive familjare që kishte qasje në internet ishte 88.8% ndërsa në vitin 2018 u rrit për 4.4 përqind krahasuar me vitin 2017 ku në vitin 2018 ishte 93.2% ndërsa në vitin 2019 nuk janë vërejtur ndryshime në përqindjen e qasjes së ekonomive familjare ku 93.2% e ekonomive familjare në Kosove kanë pasur qasje në internet në shtëpi, nga çfarëdo pajisje, ndërsa në ekonomitë familjare që nuk kanë pasur qasje në internet në shtëpi, nga çfarëdo pajisje, krahasuar me vitin 2018 ka pasur rënie prej 0.55%.

1.2 Përdorimi i internetit sipas grup moshave


Graf 2. Grup moshat që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa në vitin 2018 dhe 2019 shprehur në përqindje, (%)



Siç vërehet në Graf.2, edhe në vitin 2019 tek personat në ekonomitë familjare që kanë pasur qasje në internet në shtëpi dominon grup moshë 35-44 vjeç ku 20.5% kanë pasur qasje në internet në shtëpi, nga çfarëdo pajisje, krahasuar me vitin 2018 vërehet një rënie prej 0.1%.

1.3 Përdoruesit e internetit sipas gjinisë


Graf 3. Përdoruesit sipas gjinisë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa në vitin 2018 dhe 2019 shprehur në përqindj, (%)



Të dhënat e paraqitura në Graf.3 tregojnë se edhe në këtë vite dominon gjinia mashkull si përdorues të internetit me 55.8%. Krahasur me vitin 2018 tek përdoruesit e internetit meshkuj ka pasur një rënie prej 3.4%, ndërsa tek gjinia femër ka pasur rritje prej 3.3%.

1.4 Lloji i qasjes në internet

Graf 4. Lloji i qasjes në internet në ekonomitë familjare në vitin 2019 shprehur në përqindje, (%)




Prej 93.2% të ekonomive familjare që kanë pasur qasje në internet përmes linjës fikse dhe mobile, 91.2% janë shërbyer përmes linjës fikse, ndërsa 39.6% përmes linjës mobile. Në krahasim me vitin 2018 vërehet se nuk ka pasur ndryshim në përqindje në linjës fikse dhe mobile, rritje ka pasur edhe në përdorimin e internetit nga linja fikse prej 1 përqind ndërsa në linja mobil ka pasur rritje prej 15 përqind.

Të intervistuarit janë pyetur për linjën broadband si psh. DSL, ADSL, VDSL, internet kabllor, internet satelitor, rrjete WiFi. Në linjën mobile Broadband është përfshirë linja përmes rrjetit të telefonisë mobile, në 3G (p.sh. UMTS), duke përdorur (SIM) kartë ose USB, telefon celular ose telefonin e mençur.

2 Përdorimi i internetit nga individët 16-74 vjet në vitin 2019

2.1. Përdorimi i internetit herën e fundit


Graf 5. Përdorimi i internetit herën e fundit (në shtëpi, në punë ose në ndonjë vend tjetër) në vitet 2017-2019 shprehur në përqindje, (%)



Të dhënat në Graf 5. tregojnë qartë për përdorimin intenziv të internetit ku 90.7% e individëve që kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, ndërkohe që 8.1% e individëve janë deklaruar se asnjëherë nuk e kanë përdorur internetin, ndërsa krahasuar me vitin 2018 ka pasur një rritje prej 3 përqind e individëve që kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës ndërsa ka pasur rënie të përqindjes së individëve që asnjëherë nuk e kanë përdorur internetin për 2.5 përqind.

2.2. Përdorimi i internetit gjatë 3 muajve të fundit


Graf 6. Shpeshësia e përdorimit të internetit nga individët në ekonomitë familjare 3 muajve të fundit në vitet 2017-2019 shprehur në përqindje, (%)



Prej 90.7% e individëve të cilit kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, 87.5% kanë përdorur internetin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë, ndërsa krahasur me vitin 2018 përdorimi i internetit nga individët ka shënuar rritje prej 5 përqind.

2.3. Përdorimi i internetit disa herë gjatë ditës


Graf 7. Shpeshësia e përdorimit të internetit nga individët në ekonomitë familjare disa herë gjatë ditës në vitet 2018-2019 shprehur në përqindje, (%)



Nga grafiku i mësipërm shihet se 87.5% e individëve kanë përdorur internetin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë, ndërsa 84.4 % kanë përdorur internetin disa herë gjatë ditës në vitin 2019. Krahasuar me vitin 2018 vërejmë se përdorimi i internetit nga individët në vitin 2019 ka pasur rritje prej 12 përqind.

2.4. Përdorimi i pajisjeve elektronike për tu qasur në internet larg nga shtëpia ose puna gjatë 3 muajve të fundit


Graf 8. Përdorimi i pajisjeve elektronike për tu qasur në internet larg nga shtëpia ose puna gjatë 3 muajve të fundit në vitet 2018-2019 shprehur në përqindje, (%)



Të dhënat në Graf 8. tregojnë që 78.9% e individëve të cilit kanë pasur qasje në internet larg nga shtëpia ose puna gjatë 3 muajve të fundit në vitin 2019 përmes telefonit celular. Krahasur me vitin 2018 ka pasur rritje të përdorimit të internetit nga individët përmes telefonit celular prej 3.8 përqind.

2.5. Përdorimi i hapësirës në internet për qëllime private të shërbimeve online për ruajtjen e dokumenteve gjatë 3 muajve të fundit

Graf 9. Përdorimi i internetit për qëllime private të shërbimeve online për ruajtjen e dokumenteve, fotografive, muzikë, video ose fotografi të tjera p.sh Google Drive, Dropbox, Windows, i Cloud, Amazon Cloud Drive




Të dhënat në Graf 9. tregojnë që përdorimi i hapësirës në internet për qëllime private të shërbimeve online për ruajtjen e dokumenteve gjatë 3 muajve të fundit në vitin 2019 është 28.7 %. Krahasur me vitin 2018 përdorimi i hapësirës në internet për qëllime private ka shënuar rënie për 2.6 përqind.

3 Përdorimi i E-Qeverisë

3.1. Përdorimi i internetit për qëllime private për shërbime publike, Agjencitë Qeveritare ose administrata, gjatë 12 muajve të fundit

Graf 10. Përdorimi i internetit për qëllime private gjatë 12 muajve të fundit për të kryer shërbime nga agjencitë qeveritare ose administrata shprehur në përqindje (%)




Prej 9.52 përqind që kanë përdorur internetin për qëllime private për aktivitete si: shërbime publike, agjencitë qeveritare ose administrata, gjatë 12 muajve të fundit, ndërsa krahasuar me vitin 2018 ka pasur rënie prej rreth 9 përqind për të marrë informacion nga faqet e internetit ose aplikacionet, renje ka pasur edhe për të shkarkuar/printuar formularë zyrtar prej rreth 4 përqind dhe 4.4 përqind për të dërguar formularët e plotësuar në internet.

4 Përdorimi i E-Tregtisë

4.1. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve në internet herën e fundit


Graf 11. Blerja ose porositja e mallrave ose shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit herën e fundit në vitin 2019 shprehur në përqindje (%)



Të dhënat e paraqitura në Graf 11. tregojnë se në vitin 2019 blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve në internet nga individët 3 muaj para intervistës ishte 22.7 %. Krahasuar me vitin 2018 blerja ose porosia e mallrave përmes internetit ka pasur rritje për 5.8 përqind, ndërsa individët që asnjëherë nuk kanë blerë ose porositur mallra dhe shërbime përmes internetit ishte 59.1%.

4.2. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit gjatë 12 muajve të fundit


Graf 12. Vendet të cilat është bërë blerje ose porositja e mallrave ose shërbimeve përmes internetit për përdorim privat në vitet 2018-2019 shprehur në përqindje, (%)



Të dhënat e paraqitura në Graf 11. tregojnë se në vitin 2019 blerja ose porositja e mallrave dhe shërbimeve përmes internetit për përdorim privat gjatë 12 muajve të fundit në Kosovë ishte 27%. Krahasur me vitin 2018 blerja ose porosija e mallrave dhe shërbimeve për përdorim privat ka shënuar rritje për 9 përqind.

4.3. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit gjatë 3 muajve të fundit në vitet, 2018-2019


Graf 13. Sa herë janë blerë ose porositur mallra ose shërbime përmes internetit përdorim privat në vitin 2019 shprehur në përqindje, (%)



Gjate vitit 2019 12.1 përqind e respondentëve janë deklaruar se gjatë periudhës referuese 2019 kanë blerë ose porositur mallra ose shërbime për përdorim privat nëpërmjet internetit 1-2 herë. Krahasur me vitin 2018 kemi një rënie prej 0.8 përqind, ndërsa ka pasur rritje prej 4.6 përqind të atyre që janë deklaruar se kanë blerë ose porositur mallra ose shërbime përmes internetit 3-5 herë gjatë kësaj periudhe referuese, po ashtu të atyre që janë deklaruar për 6-10 blerje ose porosi përmes internetit ka pasur rritje prej 1.4 përqind, dhe për më shumë se 10 herë blerje ose porosi brenda kësaj pësaj periudhe ka pasur rritje prej 0.7 përqind.

4.4. Blerja ose porosia e mallrave dhe shërbimeve për përdorim privat internetit gjatë 3 muajve të fundit në vitet 2018-2019

Graf 14. Shuma e parave të shpenzuara nga individët për blerje ose porositë mallrave ose shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit në vitin 2019 shprehur në përqindje, (%)




Siç vërehet në Graf 14, në vitin 2019 11.5 përqind të respondentëve janë deklaruar se shuma e mjeteve të shpenzuara për të blerë ose porositur mallra ose shërbime përmes internetit për përdorim privat ishte më pak se 50 euro ndërsa vetëm 0.3 përqind e respondentëve janë deklaruar se kanë blerë ose porositur mallra dhe shërbime përmes internetit në vlerën 100 euro dhe më shumë. Krahasuar me vitin 2018 vërehet se ka pasur rritje prej 0.7 përqind tek blerjet ose porositë me më pak se 50 euro, ndërsa tek blerjet ose porositë deri në 1000 euro dhe më shumë ka pasur rënie prej 0.2 përqind.

5 Siguria ne internet

5.1. Kopje ose rezervë të File-ve tuaj (dokumentave, fotografive etj.) në çdo pajisje të jashtme ose në hapësirën në internetit (shërbime cloud) për qëllime private

Graf 15. Kopje ose rezervë të File për përdorim privat nëpërmjet çdo pajisje të jashtme ose në hapësirën në internetit në vitin 2019 shprehur në përqindje, (%)



Gjatë vitit 2019 përqindja e respondentëve të cilët janë deklaruar se kanë bërë kopje ose rezervë të File-ve për përdorim privat nëpërmjet çdo pajisje ruajtje të jashtme ose në hapësirën e ruajtjes së internetit ishte 35.7 %.

6 Konkluzione

Zhvillimi i shpejtë i përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit vërehet edhe prej rezultateve të anketës TIK 2019.

Në vitin 2019, 93.2 % e ekonomitë familjare në Kosovë kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa nga çfarëdo pajisje. (Graf 1)

Të dhëna në graf 2 tregojnë për përdoruesit e internetit sipas grup moshave, ku grupat moshat të cilat prijnë me 21 përqind janë moshë 35 deri 44 vjeç (Graf 2)

Përdoruesit e internetit sipas gjinisë, prijnë meshkujt me 55.8 përqind dhe femrat me 38.7 përqind të përdoruesve (Graf 3)

Prej 93.2 % të ekonomive familjare që kanë pasur qasje në internet përmes linjës fix dhe mobile, 91.2% janë shërbyer me linjën fix, ndërsa 39.6% me linjën mobile. (Graf 4)

Të dhëna në graf 5 tregojnë për përdorimin intenziv të internetit. 90.7 % e individëve që kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, ndërsa 8.1% e individëve janë deklaruar se asnjëherë nuk e kanë përdorur internetin. (Graf 5)

Prej 90.7 % e individëve të cilët kanë përdorur internetin gjatë tre muajve para intervistës, 87.5 % kanë përdorur internetin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë. (Graf 6)

Përdorimi i internetit prej 87.5 % e individëve të cilët kanë përdorur internetin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë, ku 84.4 % kanë përdorur internetin disa herë gjatë ditës. (Graf 7)

Prej 78.9 % e individëve të cilët kanë përdorur internetin larg nga shtëpia ose puna gjatë tre muajve të fundit nga telefoni celular. (Graf 8)

Prej 28.7 përdorimi i internetit për qëllime private të shërbimeve online për ruajtjen e dokumenteve, fotografive, muzikë, video ose fotografi të tjera për p.sh Google Drive, Dropbox, Windows, iCloud, Amazon Cloud Drive. (Graf 9)

Prej 9.5 % ka përdorur internetin për qëllime private për aktivitete si: shërbime publike, agjencitë qeveritare ose administrata, gjatë 12 muajve të fundit. (Graf 10)

Prej 22.7 % e individëve kanë blerë ose porositur herën e fundit mallra ose shërbime për përdorim privat nëpërmjet internetit, ka pasur një rritje prej 5.8 përqind krahasuar me vitin 2018. (Graf 11)

Prej 27 % e vendeve të cilat ëtshtë bere blerje ose porositje e mallrave ose shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit në vitin 2019. (Graf 12)

Prej 12.1 përqind e respondentëve janë deklaruar se kanë bërë blerë ose porositur mallra ose shërbime 1-2 herë për përdorim privat nëpërmjet internetit në vitin 2019. (Graf 13)

Prej 11.5 përqind të respondentëve janë deklaruar se kanë shpenzuar shumën deri ne 50 euro, për blerje ose porositje të mallrave ose shërbimeve për përdorim privat nëpërmjet internetit në vitin 2019. (Graf 14)

Prej 35.7 përqind e respondentëve janë deklaruar se kanë bërë kopje ose rezervë të File-ve për përdorim privat nëpërmjet çdo pajisje ruajtje të jashtme ose në hapësirën e ruajtjes së internetit në vitin 2019. (Graf 15)

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

311:004(496.51) “2019”(084.2)

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2019/ publikimin përgatitën Hydai Morina, Marigona Ukaj, Ahmet Cakolli. – Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. – 29 f. : ilustr. ; 24 cm. – (Seria 5: Statistikat Sociale)

1.Morina, Hydai 2. Ukaj, Marigona 3. Cakolli, Ahmet

ISBN 978-9951-22-616-5

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 159 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-616-5



9 789951 226165